



Pranuar / Dorezuar Prilloga/Protato Received/ Delivered	08.09.2023	3 viti god year	
Organ dhe/ose Organ Ijednicia Org./Unit	Nr Prot Br. Prot Prot No	Shtojta Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SPDMSHK	6025/2023		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1018/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.1018/2023 të datës 21.07.2023 të parashtruar nga ankuesi

kundër Vendimit Nr.165 të datës 20.07.2022 Komisionit të Vlerësimit për Lëvizje brenda Kategorisë të Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 si dhe neni 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 i Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 08.09.2023, mori këtë;

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.1018/2023 e datës 21.07.2023 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi Nr.165 i datës 20.07.2023 i Komisionit të Vlerësimit për Lëvizje brenda Kategorisë të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, më datë 21.07.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 5321/2023 të regjistruar nën shenjen A.nr.1018/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.165 i datës 20.07.2023 të Komisionit të Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë të Shërbimit Korrektues të Kosovës, me pretendimin ankimore se i është mohuar e drejta për tu zgjedhur si kandidatë fitues, respektivisht zhvillimi i procedurës së rekrutimit për pozitën “Zëvendës Drejtor” në kuadër të Qendrës së Paraburgimit në Pejë ka qenë në kundërshtim me ligjin, me pretendimin ankimor se Komisioni i Vlerësimit nuk e kishte vlerësuar drejtë jetëshkrimin e ankuesit dhe se në intervistën me gojë i janë bërë pyetje të cilat nuk ishin sipas kriterëve të konkursit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 02.08.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Shërbimi Korrektues i Kosovës. Ndërsa Këshilli me datë 04.08.2023 ka pranuar përgjigjen në kërkesë me numër protokolli:1018/2023 së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 21.07.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vërtetim i lëshuar nga Shërbimi Korrektues i Kosovës me numër 27 i datës 15.02.2016; Vërtetim me numër 124 i datës 22.05.2023; Vërtetim me numër 125 i datës 22.05.2023; Vlerësimi i rezultateve në punë për periudhën 01.01.2022 deri 06.07.2022 i datës 19.01.2023; Vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2022 i datës 24.01.2023; Vlerësimi i rezultateve në punë i datës 11.2.2020; Vlerësimi i rezultateve në punë i datës 17.01.2022; Vendim me numër 165 i datës 20.07.2023; Vendim me numër 738 i datës 04.07.2022; Mirënjohje e lëshuar nga Ministria e Drejtësisë e datës dhjetor 2011; Mirënjohje e lëshuar nga Ministria e Drejtësisë dhe Shërbimi Korrektues i Kosovës; Vendim i lëshuar nga Shërbimi Korrektues i Kosovës me numër 2501 i datës 30.10.2012; E-mail i dërguar nga ankuesi drejtuar KPMSHCK e datës 21.07.2023; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 02.08.2023; Përgjigja në ankesë e datës 04.08.2023; Konkursi; Lista e aplikantëve; Njoftim i lëshuar nga Shërbimi Korrektues i Kosovës i datës 23.06.2023; Njoftimi përfundimtar i verifikimit paraprak i datës 03.07.2023; E-mail i dërguar nga K.S drejtuar XH.I i datës 03.08.2023; Renditja përfundimtare e kandidatëve i datës 07.07.2023; Njoftimi i rezultateve i vlerësimit i datës 07.07.2023; Njoftimi i rezultatit përfundimtar i datës 20.07.2023; Pyetjet e Komisionit për intervistën me gojë; Aplikacioni i datës 14.06.2023; Diplomë me numër 611-454/87 i datës 30.05.1983; Diplome ë lëshuar nga Universiteti "Hasan Prishtina" me numër 976 i datës 21.10.2015; Certifikatë e lëshuar nga EULEX e datës 20.10.2022; Certifikatë e lëshuar nga EULEX e datës 09.02.2022; Certifikatë pjesëmarrje e lëshuar nga EULEX e datës 12.06.2019; Certifikatë pjesëmarrje e lëshuar nga HM Prison Service e datës 18.0.2008; Certifikatë e lëshuar nga Institucionet e përkohshme vetëqeverisëse e datës 02.02.2007; Certifikatë e lëshuar nga Seiss Project- mars 2005; Certifikatë e lëshuar nga OSCE dhe UNMIK e datës 15.11.2002; Certifikatë e lëshuar nga Ministero della Giustizia e datës 19.12.2000; Certifikatë pjesëmarrje e lëshuar nga ANTTARC e datës 11.05.2007; Certifikatë e lëshuar nga UNMIK e datës 03.03.2000; Rezultatet e ngritjes në detyrë nga UNMIK e datës 30.11.2002; Certifikatë e lëshuar nga UNMIK e datës 07.08.2003; Kontratë pune për kohë të pacaktuar e datës 15.07.2020; Kopja e letërnjoftimit dhe patentë shoferit të ankuesit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar që ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 4 përcaktohet se: *1. Nëpunësit profesional të shërbimit diplomatik dhe shërbimi korrektues janë nëpunës civilë me status të veçantë, të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të veçantë...*" nga rrjedh se nëpunësit e shërbimit korrektues kanë statusin e nëpunësve civilë me status të veçantë, respektivisht të njëjtit i nënshtrohen legjislacionit në fuqi për nëpunësit civilë si dhe ligjeve të veçanta lidhur me elementet e marrëdhënies së punës që kanë të bëjnë me: *kushte të veçanta apo shtesë për rekrutim; të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara*

me këtë ligj; rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; zhvillimin profesional dhe nevojat për trajnime; transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve, dhe se ekziston kompetenca lëndore për trajtimin e kësaj çështje ankimore në kuptim të nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Shërbimi Korrektues i Kosovës kishte publikuar konkursin për lëvizje brenda kategorisë me numër të referencës RN00011659 për pozitën "Zëvendës Drejtor" në kuadër të Qendrës së Paraburgimit në Pejë, ndërsa Kolegji i Këshillit ka gjetur se në konkursin e shpallur si kandidatë ka aplikuar vetëm ankuesi i cili pas vlerësimit nga Komisioni Përzgjedhës ka arritur të marrë gjithsej 42 pikë, ashtu që procedura për lëvizje brenda kategorisë ka përfunduar pa kandidatë fitues.

I pakënaqur me Njoftimin e Rezultateve të vlerësimit të datës 07.07.2023 për pozitën "Zëvendës Drejtor" në kuadër të Qendrës së Paraburgimit në Pejë, ankuesi brenda afatit ligjor të përcaktuar me nenin 50 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ka parashtruar ankesë në Komisionin e Vlerësimit për Lëvizje brenda Kategorisë të Shërbimit Korrektues të Kosovës, ndërsa ky i fundit me Vendimin më numër protokolli 165 të datës 20.07.2023 ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pabazuar, ndërsa ankuesi kundër Vendimit më numër protokolli 165 të datës 20.07.2023 të Komisionit të Vlerësimit për Lëvizje brenda Kategorisë të Shërbimit Korrektues të Kosovës, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji i Këshillit lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit se gjatë intervistimit me gojë i njëjti i është përgjigjur të tre (3) pyetjeve në mënyrë të kënaqshme dhe se vlerësimi ka qenë i ulët duke marrë parasysh përgjigjet e dhëna ndërsa dy (2) pyetjet tjera të cilat i janë parashtruar nga Komisioni Vlerësuar nuk ishin sipas kriterëve të konkursit, Kolegji ka analizuar pyetësorin e Komisionit Përzgjedhës të datës 07.07.2023 dhe ka ardhur në përfundim se pyetjet janë përgatitur brenda kornizës ligjore për vlerësimin e kandidatit lidhur me ushtrimin e një pozite drejtuese në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës përkitazi me cilësitë e kërkuara për pozitën e punës për të cilën zhvillohet konkurrimi, ashtu që Komisioni Përzgjedhës gjatë intervistimit të ankuesit, të njëjtit i ka parashtruar pyetje të cilat përkojnë me përshkrimin e detyrave të punës për pozitën që zhvillohet procedura si dhe në pajtueshmëri me nenin 47 paragrafi 2, 3 dhe 4 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku thuhet se: "2.Nëpërmjet intervistës, KVLBK vlerëson jetëshkrimin/CV, njohuritë, aftësitë apo cilësitë e kërkuara për pozitën e punës për të cilën zhvillohet konkurimi. 3.KVLBK përgatit përpara fillimit të intervistës një grup pyetjesh. Intervista që zhvillohet është e strukturuar dhe me pyetje të njëjta për të gjithë kandidatët e cila përgatitet në ditën e zhvillimit të intervistës.. 4.Vlerësimi maksimal në intervistën me gojë është njëqind (100) pikë" ndërlidhur edhe me nenin 48 paragrafi 1 i të njëjtës rregullore.


Sa i përket pretendimit ankimor se Komisioni Vlerësues kishte vlerësuar jetëshkrimin e ankuesit me më pakë pikë në krahasim me njohuritë, aftësitë dhe përvojën e punës, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat ligjore të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, specifikisht nenit 48 paragrafi 1 dhe 2 ku thuhet se: "1.Çdo anëtarë i KVLBK jep pikët e tij në mënyrë individuale pas vlerësimit sipas nenit 47 të kësaj rregullore. Pikët e çdo anëtari për çdo vlerësim mbledhen dhe pjesëtohen me pesë. 2.Në përfundim të fazës të

vlerësimi, pikët e përfituara nga secili kandidat në secilën nga hapat e vlerësimit, mbliidhen dhe shuma e pikëve për të gjithë hapat e vlerësimit përbën vlerësimin përfundimtar të konkurrimit.”, ashtu që vlerësimi i jetëshkrimit nga anëtarët e komisionit nuk bëhet ndaras nga intervista me gojë sikurse pretendon ankuesi, ngase sipas nenit 47 paragrafi 2 të së njëjtës rregullore përmes intervistës me gojë, gjegjësisht nga pyetjet e parashtruara dhe përgjigjet e dhëna arrihet deri tek vlerësimi i përgjithshëm duke përfshirë jetëshkrimin, njohuritë, aftësitë apo cilësitë e kërkuara për pozitën e punës dhe se legjislacioni sekondar i aplikueshmen përkitazi me ligjin material dhe ligjin e veçantë në rastin konkret për aq kohë sa nuk ka përcaktuar specifika të vlerësimit apo përcaktimit të pragut minimale të poentimit, lënë të kuptohet se ia njuh të drejtën e diskrecionit apo vendosjes se vlerësimit në mënyrë të pavarur anëtarëve të Komisionit, prandaj poentimi i ankuesit me gjithsej 42 pikë është brenda mandatit dhe kompetencave të tyre nga vlerësimi i lirë përkitazi me përgjigjet e dhëna në pyetjet e parashtruara në intervistën me gojë të mbajtur me datë 07.07.2023.

Po ashtu, duke ju referuar Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ka përcaktuar kushtet, kërkesat e veçanta dhe procedurën, për ngritjen në detyrë, përkatësisht me nenin 49 paragrafi 2 dhe 3 të kësaj rregullore përcaktohet se: “2.Kandidati që është vlerësuar me më shumë pikë dhe që ka marrë të paktën gjashtëdhjetë (60) pikë është kandidati fitues dhe ka të drejtën të emërohet në pozitën e lirë për të cilën është zhvilluar konkurrimi. Kandidati fitues në rastin e kandidatëve me pikë të barabarta përcaktohet, nga NJBNJ sipas nenit 27 të kësaj Rregulloreje, dispozitat e të cilit zbatohen përshtatshëmrisht. 3.Nëse asnjë nga kandidatët nuk është vlerësuar me gjashtëdhjetë 60 e më shumë pikë, procedura e lëvizjes brenda kategorisë përfundon pa kandidat fitues.”, Kolegji i Këshillit konstaton se ankuesi në procedurën e rekrutimit për lëvizje brenda kategorisë për pozitën e punës “Zëvendës Drejtor” në kuadër të Qendrës së Paraburgimit në Pejë është vlerësuar gjithsej me katër dhjet e dy (42) pikë të cilat janë të pamjaftueshme për tu zgjedhur kandidatë fitues ashtu siç përcaktohet edhe me dispozitën ligjore specifike me nenin 49 paragrafi 3 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ndërsa nga shqyrtimi i lëndës Kolegji i Këshillit nuk ka gjetur elemente të shkeljeve në procedurën e rekrutimit, ndërsa pretendimet e ankuesit janë refuzuara si të pabazuara sikurse në arsyetimin e këtij vendimi.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se Komisionit të Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë në Shërbimin Korrektues të Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër: 165 të datës 20.07.2023 përmes të cilit është refuzuar ankesa e ankuesit, ndërsa ka lënë në fuqi Njoftimi të rezultateve të vlerësimit të datës 07.07.2023 të Menaxherit të Personelit të Shërbimit Korrektues të Kosovës është vepruar në pajtim me nenin 38 të Ligjit Nr. 06/LI-114 për Zyrtarët Publikë sikurse edhe nenin 47 dhe 48 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe po ashtu ky vendim i goditur përmes kësaj ankese përmban elementet e aktit administrativ, ndërsa arsyetimi i tij është në pajtim me nenin 47 dhe nenin 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, pasi që kanë vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike ngase pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara në dispozitat e ligjit material dhe akteve nënligjore që rrjedhin prej tij.

Kështu që pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.



Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Lënda me numër A.nr.1018/2023

Flakron GASHI



Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Personelit në Shërbimin Korrektues të Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK-së